



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I EKONOMISË

Për trajtimin me bursë për studentët e ciklit të parë për vitin akademik 2025-2026.

Në zbatim të :

VKM-ve **Nr. 784, datë 26.12.2018 (Cikli I)**
Nr. 39, datë 23.01.2019 (Cikli I)

Për ndryshime në VKM Nr. 903, datë 21.12.2016, "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programë studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë" dhe që ju përkasin kategorive sociale sipas përcaktimeve në **VKM Nr. 903, datë 21.12.2016, (i ndryshuar)** duhet të plotësojnë dokumentacionin sipas tabelës më poshtë, për trajtimin me bursë për vitin akademik 2025- 2026.

Dokumentacioni që nevojitet për të përfituar bursë për vitin akademik 2025-2026

Shënim: Dokumentacioni që ofrohet nga e-albania nuk ka nevojë të tërhiqet në zyrat përkatëse

Nr.	Kategoria	Dokumentacioni
1	Studentët, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike	• Certifikatë familjare & Kopje ID • Vërtetim nga Njësia administrative vendore që familja e studentit trajtohet me ndihmë ekonomike • Nr. i Llogarisë nga bankat e nivelit të dytë
2	Bashkëshortët që kanë fëmijë dhe janë të dy studentë, përfitojnë secili bursë financiare	• Certifikatë familjare & Kopje ID • Vërtetim studentit nga institucionet publike IAL • Nr. i Llogarisë nga bankat e nivelit të dytë
3	Personat (Student) me aftësi të kufizuar, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punës, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar	• Kopje ID • Vërtetim i pagesës nga DRSSH • Noterizim i vendimit të K.M.C.A.P • Nr. i Llogarisë nga bankat e nivelit të dytë
4	Studentët të cilët kanë të dy prindërit me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të KMCA, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar.	• Certifikatë familjare & Kopje ID • Vërtetimi pagesës nga DRSSH (për të dy prindërit) • Noterizim i vendimit të KMCA për prindin me aftësi të kufizuar. (për të dy prindërit) • Nr. i Llogarisë nga bankat e nivelit të dytë
5	Studentët që i kanë të dy prindërit pensionistë ose njërin prind pensionist dhe prindi tjetër nuk jeton	• Certifikatë familjare • Kopje ID • Vërtetimi pagesës së pensionit nga DRSSH • Nr. i Llogarisë nga bankat e nivelit të dytë
6	Studentët, të tretët në radhën e fëmijëve e lart, të cilët vijnë nga familje me tre fëmijë e më shumë, nga të cilët dy të parët janë studentë në institucionet publike të arsimit të lartë	• Certifikatë familjare & Kopje ID • Vërtetimi që të dy fëmijët e parë janë studentë në IAL Publike • Nr. i Llogarisë nga bankat e nivelit të dytë
7	Studentët që kanë përfituar statusin e jetimit deri në moshën 25 vjeç	• Kopje kartë indentiteti • Libreza e statusit të jetimit lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror (Bazuar në ligjin Nr.8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e Jetimit", Përfitojnë statusin e jetimit personat me moshë nga 0-25 - Vjeç dhe që plotësojnë këto kriterë: a) të lindurit jashtë martese; b) që nuk kanë gjallë asnjërin nga prindërit; c) të cilëve me vendim të formës së prerë të gjykatës u është hequr e drejta prindërore e të dy prindërve ose u është hequr e drejta prindërore për njërin prind dhe prindi tjetër nuk jeton; d) që braktisen nga të dy prindërit dhe nuk u njohet identiteti i tyre.
8	Studentët që kanë humbur përgjegjësinë prindërore, me vendim gjykatë të formës së prerë deri në moshën 25 vjeç	• Certifikatë familjare & Kopje ID • Vendim gjykatë të formës së prerë • Nr. i Llogarisë nga bankat e nivelit të dytë
9	Studentët që janë identifikuar e trajtuar si viktimat të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë humbur kujdesin prindëror deri në moshën 25 vjeç	• Kopje ID • Vërtetim nga Ministria e Brendshme • Nr. i Llogarisë nga bankat e nivelit të dytë
10	Studentët që rezultojnë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.	• Kopje ID • Shkresa nga Ministria përkatëse • Nr. i Llogarisë nga bankat e nivelit të dytë
11	Studentët e pranuar në vitin e parë të ciklit të parë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe që kanë ardhur nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë).	• Kopje ID • Nr. i Llogarisë nga bankat e nivelit të dytë • Lista emërore e studentëve vjen nga Ministria Arsimit (agjencia përkatëse)
12	Studentët që rezultojnë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), të regjistruar në vitin pas të parit (studentët e vitit të dytë dhe të tretë) dhe që kanë shlyer të gjitha detyrimet akademike të parashikuara për vitin akademik paraardhës.	• Kopje ID • Nr. i Llogarisë nga bankat e nivelit të dytë • Lista emërore e studentëve vjen nga Sekretaria Mësimore

Dokumentacioni dorëzohet pranë Degës së Shërbimeve FE-UT (kati i dytë godina 3-katëshe A) brenda datës 14 nëntor 2025 ora 9:00-15:00

Kujdes! Të gjithë studentët që aplikojnë për Bursë duhet të kenë të përfshirë në dosjen e tyre **Numrin e Llogarisë Bankare** të lëshuar me dokument nga **Bankat e Nivelit të Dytë**.
Email: degasherbimeve@feut.edu.al